



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë- Ministarstva za Obrazovanje Nauku i
Tehnologiju-Ministry of Education Science & Technology*

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/ Cabinet of the Minister

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), në mbështetje të nenit 145 pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës, (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 12 dhe të Ligjit për Arsimin e Lartë (nr. 04/L-032), duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), nxjerr këtë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Caktimi i formës dhe i përmbajtjes së diplomave dhe shtojcave të diplomave të Bartësve të Arsimit të Lartë (BAL) në Kosovë

NUMËR: 02/2012

DATË: 30.03.2012

Neni 1
Qëllimi

Me Udhëzimin administrativ për përmbajtjen dhe formën e diplomave të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë (IAL) në Kosovë (në tekstin e mëtejme UA), përcaktohet përmbajtja dhe forma e dokumenteve në vijim me rastin e dhënies së gradave Bachelor, Master, Doktor si dhe çdo gradë tjetër që jepet pas shkollimit të mesëm në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (KEK) për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi ECTS- European Credit Transfer System (Sistemi Evropian i Transferit të Kredive).

Neni 2

Afati për lëshimin e diplomës

1. Diplomat Bachelor, Master, Doktoratë si dhe çdo diplomë tjetër që është në kuadër të arsimit të lartë, duhet të lëshohen në afat prej 4 (katër) javësh nga dita e diplomimit/plotësimit të kushteve për fitimin e diplomës.
2. Ceremonia e promovimit e të diplomuarve në doktoratë organizohet sipas rregullave të veçanta të përcaktuara në statutin e institucionit përkatës.

Neni 3

Shtojca e diplomës

Me qëllim të lehtësimit të mobilitetit ndërkombëtar të studentëve, diplomës do t'i bashkëngjitet shtojca e diplomës në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhën angleze.

Neni 4

Përmbajtja e diplomës Bachelor

1. Diploma që merret në IAL, me të cilën fitohet grada *Bachelor i shkencave/ Bachelor i arteve/ Bachelor profesional si* dhe gradat tjera të nivelit 6 dhe ato të nivelit 5 që janë në kuadër të arsimit të lartë të bazuara në Sistemin Evropian të Transferit të Kredive (ECTS), do të përmbajë si në vijim:
 - 1.1. Simbolin (logon) e Republikës së Kosovës, në këndin e epërm të majtë të diplomës;
 - 1.2. Simbolin (logon) e universitetit/institucionit përkatës, në këndin e epërm të djathtë të diplomës;
 - 1.3. Emrin e fakultetit/njesisë dhe selinë e tij;
 - 1.4. Emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin, datëlindjen dhe vendlindjen e kandidatit/kandidates;
 - 1.5. Vitin akademik të regjistrimit në fakultetin/njësine gjegjëse;
 - 1.6. Datën e kryerjes së studimeve në atë fakultet/njësi;
 - 1.7. Drejtimin e ngushtë të studimeve;
 - 1.8. Gradën e fituar;
 - 1.9. Nivelin e kualifikimit sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve- KKK/ KEK;
 - 1.10. Numrin e ECTS kredive të fituara;
 - 1.11. Notën mesatare gjatë studimeve;
 - 1.12. Datën dhe numrin e protokollit të diplomës;
 - 1.13. Nënshkrimet e dekanit/udhëheqësit të fakultetit/njesisë përkatës/e dhe të rektorit të universitetit ose personit përgjegjës të institucionit, vulën e thatë të institucionit përkatës.

Neni 5

Përmbajtja e diplomës Master

1. Diploma për studimet e kryera pasuniversitare për marrjen e gradës

Master i shkencave / Master i arteve/ Master profesional si dhe diplomat e gradave të tjera të nivelit 7 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve do të përmbajë si në vijim:

- 1.1. Simbolin (logon) e Republikës së Kosovës, në këndin e epërm të majtë të diplomës;
- 1.2. Simbolin (logon) e universitetit/institucionit përkatës, në këndin e epërm të djathtë të diplomës;
- 1.3. Emrin e fakultetit/njesisë dhe selinë e tij;
- 1.4. Emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin e kandidatit/kandidates, datëlindjen dhe vendlindjen e tij/saj;
- 1.5. Vitin akademik të regjistrimit në fakultetin/njësine përkatës/e;
- 1.6. Datën e mbrojtjes së temës së diplomës-Master;
- 1.7. Numrin e ECTS kredive të fituara;
- 1.8. Notën mesatare gjatë studimeve;
- 1.10. Titullin e punimit-Master;
- 1.11. Fushën shkencore të temës së mbrojtur të diplomës-Master;
 - 1.11.1 Gradën e fituar;
 - 1.11.2. Nivelin e kualifikimit sipas KKK/ KEK;
 - 1.11.3. Datën dhe numrin e protokollit të diplomës;
 - 1.11.4. Nënshkrimet e dekanit/udhëheqësit të fakultetit/institucionit përkatës dhe të rektorit të universitetit ose personit përgjegjës të institucionit, vulën e thatë të institucionit përkatës.

Neni 6

Përmbajtja e diplomës së Doktoratës

1. Diploma për marrjen e gradës shkencore Doktor i fushës përkatëse do të përmbajë:
 - 1.1. Simbolin (logon) e Republikës së Kosovës, në këndin e epërm të majtë të diplomës;
 - 1.2. Simbolin (logon) e universitetit/institucionit përkatës, në këndin e epërm të djathtë të diplomës;
 - 1.3. Emrin e fakultetit/njesisë dhe selinë e tij/saj;
 - 1.4. Emrin, emrin e prindit dhe mbiemrin e kandidatit/kandidates, datëlindjen dhe vendlindjen e tij/saj;
 - 1.5. Vitin e regjistrimit në studimet e Doktoratës;
 - 1.6. Datën e mbrojtjes së temës së Doktoratës;
 - 1.7. Numrin e ECTS kredive të fituara;
 - 1.8. Titullin e temës së punimit të Doktoratës;
 - 1.9. Fushën shkencore të temës së Doktoratës;
 - 1.10. Gradën e fituar;
 - 1.10.1 Nivelin e kualifikimit sipas KKK/ KEK.
 - 1.11. Datën dhe numrin e protokollit të diplomës;
 - 1.12. Nënshkrimin e dekanit/udhëheqësit të fakultetit/njesisë, nënshkrimin e rektorit ose kolegjiut universitar të universitetit dhe vulën e thatë të institucionit përkatës.

Neni 7
Forma e diplomave

Diploma e institucionit të arsimit të lartë duhet të ketë formën e katërkëndëshit kënddrejtë.

Neni 8
Dimensioni i diplomave

Diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë do të kenë këto dimensione: 25,8 cm (e lartë) x 37,4 cm (e gjerë).

Neni 9
Dizajni i diplomave

Bartësit e Arsimit të Lartë përcaktojnë dizajnin e diplomave të veta, por u përmbahen udhëzimeve të këtij UA.

Neni 10
Letra dhe ngjyra e diplomave

Diplomat do të shtypen në letër të fortë, të cilësisë së lartë, letër fisnike "Sirioterl" 230 gram.

II. Shtojca e diplomës

Neni 11
Shtojca e diplomave (diplomës)

1. Shtojca e diplomës (ShD) është dokument shoqërues i Diplomës së fituar në një institucion të arsimit të lartë, e cila ofron përshkrim të standardizuar për natyrën, nivelin, kontekstin, përmbajtjen dhe statusin e studimeve të përfunduara nga i diplomuari.
2. Institucionet e arsimit të lartë janë të obliguara që të diplomuarve t'u lëshojnë shtojcën e diplomës të vulosur, në përputhje me nenin 16, pika 8 e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës si dhe nenit IX/3 të Konventës për njohjen e Kualifikimeve në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. (Konventa për Njohjen e Lisbonës, 1997).
3. Shtojca e diplomës (shih formularin e bashkëngjitur si shtojcë nr. 1), shërben për të shpjeguar kualifikimin dhe kompetencën që zotëron poseduesi i saj që ato të mund të kuptohen në shkallë ndërkombëtare.

Neni 12
Funksioni i shtojcës së diplomës

1. Shtojca e diplomës shpjegon kualifikimin e dhënë nga IAL.
2. Shtojca e diplomës duhet ti lëshohet të diplomuarit njëkohësisht me origjinalin e diplomës së fituar dhe jepet falas.

3. Shtojca e diplomës është valide vetëm kur është e bashkangjitur me origjinalin e diplomës së fituar. Si shtojcë (dokument i vetmuar) nuk ka fuqi ligjore. Shtojca e diplomës e lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë në Kosovë, duhet të përmbajë të gjitha informacionet e parapara në modelin e ShD të zhvilluar nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë–UNESCO (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization)/Qendra evropiane për arsimin e lartë-CEPES (Centre Européen pour l'Enseignement Supérieur).
4. Institucionet e arsimit të lartë në Kosovë janë të obliguara që shtojcën e diplomës ta lëshojnë në gjuhë zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në gjuhën angleze.
5. Shtojca e diplomës duhet të përmbajë simbolin (logon) e institucionit përkatës, në këndin e epërm të djathtë të shtojcës së diplomës.

Neni 13

Përmbajtja e shtojcës së diplomës

1. Përmbajtja e Shtojcës së Diplomës bëhet sipas modelit të Komisionit Evropian dhe UNESCO/CEPES, i cili është i bashkëngjitur në këtë Udhëzim administrativ.
2. Informacionet për sistemin kombëtar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, i ofron Departamenti i Arsimit të Lartë nëpërmjet një përshkrimi të shkurtër (maksimum dy faqe) duke iu referuar Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Këto informacione i përdorin të gjitha institucionet e arsimit të lartë. Në raste kur ndodhin ndryshime në sistem të arsimit të lartë, departamenti i arsimit të lartë riformulon përshkrimin dhe i njofton institucionet e arsimit të lartë.
3. Informacioni për sistemin kombëtar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës është i përfshirë në pikën 8 të Shtojcës së Diplomës.

Neni 14

Letra e shtojcës së diplomave

Shtojcat e diplomës lëshohen në letër të formatit A4 në dy deri në tri faqe (shih formatin e shtojcës së diplomës, bashkëngjitur si shtojcë nr. 1 këtij udhëzimi administrativ):

Neni 15

Dizajni i shtojcës së diplomave

1. Bartësi i Arsimit të Lartë përcakton dizajnin e shtojcës së diplomës së vet, por është i obliguar që t'u përmbahet udhëzimeve themelore të paraqitura në nenin 13 dhe formatin e bashkëngjitur të këtij udhëzimi administrativ.
2. Forma dhe përmbajtja e shtojcës së diplomës rekomandohet nga Agjencioni Kosovar i Akreditimit- AKA dhe aprovohet nga MASHT-i.



SHTOJCA E DIPLOMËS – DODATAK DIPLOME – SUPLEMENT / DIPLOMA SUPPLEMENT

UNIVERSITETI I PRISHTINËS UNIVERZITET U PRIŠTINI UNIVERSITY OF PRISHTINA

Kjo shtojcë është hartuar në bazë të modelit të hartuar nga Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës dhe UNESCO/CEPES. Qëllimi i shtojcës është që të siguroj të dhëna të pavarura dhe të mjaftueshme për përmirësimin e “transparentës” ndërkombëtare si dhe njohjes akademike dhe profesionale të kualifikimeve (diplomave, titujve shkencor, certifikatave, etj). Është dizajnuar që të ofroj përshkrimin e natyrës, nivelit, kontekstit dhe statusit të studimeve të cilat individi, emri i të cilit është në kualifikimin origjinal, i ndjek dhe i kryen me sukses për çka edhe kjo shtojcë sqaron. Duhet të jetë e pa anuar nga gjykimet për vlerën, ekuivalencën apo sugjerimet për njohjen. Duhet të jepen informacione në të gjithë tetë sektorët. Aty ku informacionet nuk jepen, duhet të sqarohet arsyeja pse.

Ovaj dodatak je sastavljen na osnovu modela sastavljenog od strane Evropske komisije, Saveta Evrope i UNESCO/CEPES. Cilj dodatka je da obezbedi dovoljno nezavisnih podatak i da poboljšanja međunarodnu “transparentnost” kao i akademska i profesionalna priznanja kvalifikacija (diploma, naučna zvanja, certifikate, itd). Dizajniran je da omogući opis nivoa, prirodu, kontekst i statut studiranja pojedina, ime koje je na original kvalifikacije, prati i uspešno završava zašto i ovaj dodatak to objašnjava. Treba biti nepristrasna prema predrasudama vrednost, ekvivalentnosti ili sugestija o priznanju. Treba da pruža informacije za sve sektore. Gde informacija nisu date, treba obrazložiti zašto.

This Diploma Supplement follows the model developed by the European Commission, Council of Europe and UNESCO/CEPES. The purpose of the supplement is to provide sufficient independent data to improve the international ‘transparency’ and fair academic and professional recognition of qualifications (diplomas, degrees, certificates etc.). It is designed to provide a description of the nature, level, context, content and status of the studies that were pursued and successfully completed by the individual named on the original qualification to which this supplement is appended. It should be free from any value judgements, equivalence statements or suggestions about recognition. Information in all eight sections should be provided. Where information is not provided, an explanation should give the reason why.

1. INFORMACIONE IDENTIFIKUESE TË BARTËSVE TË KUALIFIKIMEVE / IDENTIFIKACIONE INFORMACIJE NOSIOCE KVALIFIKACIJA / INFORMATION IDENTIFYING THE HOLDER OF THE QUALIFICATION 1.1 Emri /Ime/ Name 1.2 Mbiemri /Prezime/ Surname 1.3 Data e lindjes (data / muaji / viti) / Datum rođenja (datum/mesec/godina)/ Date of birth (day/month/year) 1.4 Numri i studentit (dosja)/ Broj studenta (dosijea)/ Student identification numbers 1.5 Data e regjistrimit dhe përfundimit/ Datum upisa i završavanja/ Date of registration and completion 	3. INFORMACIONE PËR NIVELIN E KUALIFIKIMIT TË FITUAR/ INFORMACIJE ZA NIVO STEČENE KVALIFIKACIJE / INFORMATION ON THE LEVEL OF THE QUALIFICATION 3.1 Niveli i kualifikimit/Nivo kvalifikacije/ Level of qualification 3.2 Kohëzgjatja zyrtare e programit (studimeve) Službeni vremenski period trajanja (studiranja)/ Official length of programme (studies) 3.3 Pragu i pranimit në institucion / Prag primanja u instituciji / Accessible creteria at the institution
2. INFORMACIONE IDENTIFIKUESE PËR KUALIFIKIMIN E FITUAR/ INFORMACIONE KVALIFIKACIJE ZA STEČENU KVALIFIKACIJU/ INFORMATION IDENTIFYING THE QUALIFICATION 2.1 Emri i kualifikimit dhe emri i gradës (e plotë / e shkruar) Ime kvalifikacije i ime čina (puno/napisano) Name of qualification and degree (complete/ëritten) 2.2 Fusha(t) kryesore të kualifikimit (studimit) Glavna(e) oblast(i) kvalifikacije (studiranja) Main field(s) of study for the qualification 	4. INFORMACIONE PËR PËRMBAJTJEN DHE REZULTATET E ARRITURA/ INFORMACIJE O SADRŽAJU I POSTIGNUTIH REZULTATA/ INFORMATION ON THE CONTENTS AND RESULTS GAINED 4.1 Mënyra e studimit (i/e rregullt- me korrespondencë) Način studiranja (redovno- vanredno) Mode of study (full time/part time) 4.2 Kërkesat e programit /Programski zahtevi/ Programme requirements 4.3 Shih faqen e fundit / Vidi zadnju stranicu/ Please, see the last page

2.3 Emri dhe statusi i institucionit që e lëshon kualifikimin(në gjuhën origjinale)
Ime i statut institucije koja izdajekvalifikaciju (na originalnom jeziku)
Name and status of institution issuing the qualification (in original language)

--

2.4 Emri dhe statusi i institucionit (nëse ndryshon nga 2.3) që administron studimet (në gjuhën origjinale) /
Ime i statut institucije (ukoliko se razlikuje od 2.3) koja administrira studije (na originalnom jeziku)/
Name and status of institution (if it's different from 2.3) which administer studies (in original language)

--

2.5 Gjuha e studimit / Jezik studiranja /
Language of study

--

5. INFORMACIONE PËR FUNKSIONIN E KUALIFIKIMIT / INFORMACIJE ZA FUKSIJU KVALIFIKACIJE / INFORMATION ON THE FUNCTION OF THE QUALIFICATION

5.1 Pranimi për studimet e mëtejme / Prijem za dalje studije / Access to further study

--

5.2 Statusi profesional (nëse ekziston)/ Profesionalni statut (ako ima) / Professional status (if applicable)

--

4.4 Skema e notimit, udhëzim për përshkrimin e notave / Šema ocenjivanja, uputstvo za opis ocena / Grading scheme, grade distribution guidance

4.5 Klasifikimi i përgjithshëm i kualifikimit (në gjuhën origjinale)/ Opšta klasifikacija kvalifikacije (na originalnom jeziku) / Overall classification of the qualification (in original language)

--

6. INFORMACIONE SHITESË / DODATNE INFORMACIJE / ADDITIONAL INFORMATION

6.1 Informata shitesë / Dodatne informacije/ Additional information

--

6.2 Burimet e informatave shitesë / Izvori dodatnih informacija / Further information sources

--

- 5.3** Detajet e programit (p.sh modulet apo njësitë e ndjekura) si dhe notat/kreditet/nivelet e ndjekura
- Programski detalji (npr. moduli ili praćena jedinica) kao i ocene/krediti/praćeni nivoi /
 - Programme details (e.g. modules or units studied) grades/marks/credits obtained:

7. CERTIFIKIMI I SHTOJCËS (certifikatë shtesë) / CERTIFIKACIJA DODATKA (dodatni certifikat)/ CERTIFICATION OF THE SUPPLEMENT

INSTITUCIONI / INSTITUCIJA/ INSTITUTION

ORGANI QË E LËSHON / AWARDING BODY

7.1 Data / Datum/Date

Data / Datum/Date

7.2 Nënshkrimi / Potpis/Signature

Nënshkrimi /Potpis/ Signature

7.3 Kapaciteti/
Kapacitet /
Capacity

7.4 Vula zyrtare/
Službeni pečat/
Official stamp or seal

Kapaciteti/
Kapacitet /
Capacity

Vula zyrtare/
Službeni pečat/
Official stamp or seal

8. Informacione për sistemin kombëtar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.

8.1 Sipas Ligjit (nr. 04/L-037) për Arsimin e Lartë, arsim i lartë në Republikën e Kosovës konsiderohet çdo arsimim pas shkollës së mesme të lartë (Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar), në nivelet 5, 6, 7 dhe 8 të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të cilin mund të jepen kredi (ECTS). Në përputhje me Procesin e Bolonjës, arsimi i lartë në Republikën e Kosovës organizohet në tri cikle: Bachelor, Master dhe Doktoratë.

8.2. Kualifikimet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, mund të jenë akademike apo profesionale dhe mund të jepen nga institucionet (bartësit) e arsimit të lartë si “Universitetet”, “Kolegjet Universitare”, “Kolegjet”, “Institutet”, “Shkollat” ose “Akademitë”. Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Ligjin për Kualifikimet Kombëtare, akreditimin e programeve dhe institucioneve të cilat ofrojnë kualifikime në arsim të lartë e bën Agjencioni Kosovar i Akreditimit- AKA.

8.3. Institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, si publike ashtu edhe private, e përdorin Sistemin evropian për mbledhje dhe transfer të kredive (ECTS- European Credit Accumulation and Transfer System). Në IAL në Kosovë, ngarkesa vjetore e një studenti të rregullt vlerësohet të jetë 1500 orë, prandaj një ECTS kredi është e barabartë me 25 orë të mësimi të planifikuar.

Për më shumë informata vizitoni:

www.mont-gov.net ; www.akreditimi-ks.org; www.akk-ks.net

8. Informacije o nacionalnog sistema za visoko obrazovanje u Republici Kosova.

8.1 U skladu sa zakonom (br.04/Z-037) za Visoko obrazovanje, visoko obrazovanje u Republici Kosova smatra se svakakvo obrazovanje nakon više srednje obrazovanje (Zakon br. 04/Z-032 za Preduniverzitetsko obrazovanje), na nivo 5,6,7 i 8 Evropskog okvira za kvalifikacije za učenje tokom celog života, za koje se mogu dati krediti (ECTS). U skladu sa Bolonjskim procesom, visoko obrazovanje u Republici Kosova organizuje se u tri ciklusa: Bachelor, Master i Doktorat.

8.2 Kvalifikacije visokog obrazovanja u Republici Kosova, mogu biti akademske ili profesionalne i mogu biti dodeljene od strane institucije (nosioce) visokog obrazovanja kao “Univerziteti” “univerzitetski koledže”, “Koledž”, “Institut”, “Škole”, ili “ Akademije”. Na osnovu zakona o visokom obrazovanju i Zakona o nacionalnim kvalifikacijama, akreditaciju programa i institucija koje nude kvalifikacije za visoko obrazovanje izdaje Kosovska agencija za akreditaciju – KAA .

8.3 Institucije visokog obrazovanja u Republici Kosova, kao javne takode i privatne, koriste Evropski sistem za prikupljanje i prenos kredita (ECTS European Credit Accumulation and Transfer System). U IVO Na Kosovu, godišnje obaveze redovnog studenta procenjuje se da bude 1500 časova, tako da jedan ECTS kredit je jednako sa 25 nastavnih planiranih časova.

Za više informacije posetite:

www.mont-gov.net ; www.akreditimi-ks.org; www.akk-ks.net

8. Information on National Higher Education System in the Republic of Kosovo

8.1 According to the Law (No.04/L-037) on Higher Education, higher education in the Republic of Kosovo is considered any post- upper secondary education (Law No.04/L-032 on pre-university education), at levels 5, 6, 7 and 8 of the European Qualifications Framework for Lifelong Learning for which ECTS credits may be granted. In line with the Bologna Process, higher education in the Republic of Kosovo is organized in three cycles: Bachelor, Master and PhD.

8.2 Higher education qualifications in the Republic of Kosovo may be either academic or vocational and can be issued by institutions (holders) of higher education such as “Universities”, “University Colleges”, “Colleges”, “Institutes”, “Schools”, or “Academies”. Based on the Law on Higher Education and the Law on the National Qualifications the accreditation of programs and institutions offering qualifications in higher education is done by the Kosovo Accreditation Agency-KAA.

8.3 Both public and private institutions of higher education in the Republic of Kosovo use the ECTS system (European Credit Accumulation and Transfer System). In Higher Education Institutions in Kosovo the annual full-time student workload is estimated at 1500 hours, making one ECTS kredit equal to 25 hours of planned classes.

For more information visit:


www.masht-gov.net; www.akreditimi-ks.org; www.akk-ks.net

Neni 16
Dispozitat kalimtare

Më hyrjen në fuqi të këtij UA shfuqizohet Udhëzimi administrativ nr. 38/2008 dt. 04.11.2008, Caktimi i formës dhe i përmbajtjes së diplomave dhe shtojcave të diplomave të Bartësve të Arsimit të Lartë (BAL) në Kosovë dhe UA 1/2012 dt. 05.03.2012 Caktimi i formës dhe i përmbajtjes së diplomave dhe shtojcave të diplomave të Bartësve të Arsimit të Lartë (BAL) në Kosovë

Neni 17
Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.


Prof. dr. Ramë Buja, ministër

